



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



BUXHETI

2010

Prishtinë
Nëntor, 2009

Vizioni

“ZRRUM është faktor kyç për ngritjen e cilësisë së shërbimeve të ujit për të gjithë konsumatorët në tërë Kosovën.”

Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave të ngurta në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave japin shërbime kualitative, të qëndrueshme, të besueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrotjen e shëndetit publik.”

PARATHËNIE	2
1. PJESA E PËRGJITHSHME	3
1.1. THEMELIMI DHE PËRGJEGJËSITË LIGJORE TË ZRRUM-IT	3
1.2. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRUM-IT	4
2. SYNIMET OPERATIVE TË ZRRUM-IT.....	7
2.1. SYNIMET OPERATIVE.....	7
3. TË HYRAT E ZRRUM-IT NË 2009	11
3.1. TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT	11
3.2. DONACIONET.....	11
4. SHPENZIMET E ZRRUM-IT NË 2009	15
4.1. SHPENZIMET E PERSONELIT (PAGAT DHE MËDITJET).....	15
4.2. MALLËRA DHE SHËRBIME.....	17
4.3. SHPENZIMET TOTALE TË ZRRUM PËR VITIN 2009	18
5. KONKLUZION.....	19

Ky dokument jep një përmbledhje të aktiviteteve të planifikuara të Zyrës Rregullore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) për vitin 2010 dhe shqyrton mundësinë për financimin e këtyre aktiviteteve.

Dokumenti presupozon se ZRRUM do të jetë në gjendje që në tërësi ti financojë aktivitetet a planifikuara nga taksat vjetore të licencimit që paguhen nga ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave. Kjo formë e financimit të ZRRUM-it është në pajtim me Ligjin për Rregullimin e Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimeve të Ujës, Kanalizimit dhe Mbeturinave dhe që është në përputhje me principet e pavarësisë rregullore dhe praktikën e mira për financimin e rregullatorëve ekonomik. Ky Lighj e ka zëvendësuar Rregulloren e UNMIK 2004/49 përmes të cilës është themeluar ZRRUM dhe paraqet kuadrin ligjor për punën e ZRRUM-it.

Pjesë përbërëse e këtij dokumenti janë edhe shpenzimet e parapara për financimin e aktiviteteve të planifikuara të ZRRUM-it në 2010. Shpenzimet janë ndarë në grupe standarde: Shpenzimet e Personelit, Mallëra dhe Shërbime, dhe Shpenzime Kapitale.

Buxheti i ZRRUM përmban kapitujt vijues:

- Synimet Operative
- Të Hyrat
- Shpenzimet
- Pagat dhe Mëditjet
- Mallëra dhe Shërbime
- Shpenzimet Kapitale
- Konkluzion

1. Hyrje

1.1. Themelimi dhe Përgjegjësitë Ligjore të ZRRUM-it

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) është rregullator ekonomik i sektorëve të ujit dhe mbeturinave në Kosovë që është themeluar më 26 Nëntor të vitit 2004 me **Rregulloren e UNMIK 2004/49** në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës e cila Rregullore përmes Ligjit **Nr. 03/L-086** të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më datë 13 Qershor 2008 është shndërruar në Ligjin për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetillësit, kanalizimit dhe Mbeturinave.

ZRRUM është përgjegjës për rregullimin e Ndërmarrjeve Publike që ofrojnë shërbimet e ujësjetillësit, kanalizimit, mbledhjes së mbeturinave, dhe deponimit të mbeturinave.

Përgjegjësitë kryesore të ZRRUM janë:

- Përcaktimi i tarifave që balancojnë nevojat e konsumatorëve për çmime të përballueshme dhe ruajtjen e integritetit financiar të ofruesve të shërbimeve,
- Lëshimi i licencave për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave,
- Nxitja e konkurrencës në sektorët e ujit dhe mbeturinave përmes krahasimit të performancës (“benchmarking”),
- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve duke siguruar që ofruesit e shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e tyre monopolistike dhe duke siguruar që shërbimet ofrohen në pajtim me standardet adekuate dhe të përcaktuara të shërbimit,
- Monitorimi dhe raportimi i performancës së ofruesve të shërbimeve,
- Themelimi dhe përkrahja e këshillave konsultative për konsumatorë,
- Miratimi i kushteve për falje dhe shlyerje të borxheve nga e kaluara.

Pra, thënë shkurt, ZRRUM është përgjegjës për të siguruar se Ndërmarrjet Publike që ofrojnë shërbimet e ujësjetillësit dhe mbeturinave në Kosovë iu ofrojnë konsumatorëve shërbime efçente dhe cilësore me çmim të arsyeshëm dhe korrekt.

Në përmbushjen e përgjegjësisë së veta rregullatore, ZRRUM udhëhiqet nga korniza ligjore që është përcaktuar me Rregulloren 2004/49 dhe Ligjin Nr. 03/L-086 dhe legjislacionin tjetër që ka të bëjë me sektorët e ujit dhe mbeturinave. Në mënyrë më të hollësishme korniza ligjore është dhënë me legjislacionin sekundar (në formën e 14 Rregullave) të nxjerrë nga ZRRUM në Janar të vitit 2005 dhe të amendamentuar kohëpaskohe.

ZRRUM deri në aprovimin e Ligjit Nr. 03/L-086, i është përgjigjur Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të Kombeve të Bashkuara. Pas aprovimit të këtij ligji përgjegjësia e ZRRUM-it ka kaluar te Kuvendi i Kosovës.

1.2. Struktura Organizative e ZRRUM-it

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-086 ZRRUM udhëhiqet nga Drejtori dhe Zv. Drejtori si persona përgjegjës për funksionimin e Zyrës si dhe për marrjen e vendimeve rregullatore.


Me qëllim të operimit më eficient, efektiv dhe me kohë, ZRRUM ka aprovuar strukturën organizative të organizimit sipas të cilës departamentet e ZRRUM-it i përgjigjen direkt Drejtorit të ZRRUM-it.

ZRRUM përbëhet nga katër departamente, tri prej të cilave janë përgjegjëse për aktivitetet rregullatore dhe një departament ofron mbështetje për punën e Zyrës. Departamentet përgjegjëse për aktivitetin rregullator janë: Departamenti i Tarifave dhe Financave Rregullatore, Departamenti i Performansës, dhe Departamenti për Ligj dhe Licenca, ndërkaq përgjegjës për mbështetjen e biznesit të ZRRUM-it është Departamenti për Administratë dhe Financa.

Organizimi i brendshëm dhe procedurat administrative dhe rregullatore në bazë të së cilave funksionon ZRRUM-i janë përcaktuar me një dokument të veçantë të nxjerrë nga Drejtori i ZRRUM-it.

Struktura organizative e ZRRUM-it është dhënë në vijim:

Figura 1: Struktura Organizative e ZRRUM



Departamenti i Tarifave dhe Financave Rregullatore

Departamenti i Tarifave dhe Financave Rregullatore i ofron mbështetje të nevojshme Drejtorit të ZRRUM-it në përcaktimin e tarifave të shërbimit për ofruesit e licencuar të shërbimeve. Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të këtij Departamenti përfshijnë:

- (i) zhvillimin e metodologjisë dhe modeleve për llogaritjen tarifave të shërbimit,
- (ii) zhvillimin e praktikave dhe procedurave për aplikimin dhe shqyrtim të aplikacioneve për tarifa të shërbimit,
- (iii) udhëheqjen e procesit të përcaktimit të tarifave në frymën dispozitave ligjore në fuqi,
- (iv) shqyrtimin dhe evaluimin e të dhënave financiare nga raportet e kompanive të licencuara,
- (v) auditimin e të dhënave financiare të kompanive të licencuara, dhe
- (vi) mbështetjen në hartimin e legjislacionit sekundar të ZRRUM-it.

Departamenti i Monitorimit të Performansës

Roli i Departamentit të Monitorimit të Performansës është që të organizojë sistemin e raportimit të kompanive të licencuara të ZRRUM-i dhe të përkujdeset për funksionimin e këtij sistemi. Në mënyrë të veçantë ky Seksion ka përgjegjësi për analizimin dhe vlerësimin e të dhënave të raportuara dhe përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore lidhur me performansën operative dhe financiare të ofruesve të licencuar të shërbimit.

Poashtu, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të Departamentit të Monitorimit të Performansës përfshihen edhe aspektet që kanë të bëjnë me shërbimet ndaj konsumatorëve (bashkëpunimi me dhe mbështetja e punës së Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve, shqyrtimi i aplikacioneve lidhur me shkyçjet kolektive, vlerësimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit etj.).

Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Licencimit

Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Licencimit i ofron mbështetje të nevojshme ligjore Drejtorit dhe stafit të ZRRUM-it në lidhje me aktivitetet e ZRRUM-it dhe përfaqëson Zyrën në të gjitha seancat administrative dhe gjyqësore para autoriteteve administrative, instancave të arbitrit, dhe gjykatave të Kosovës.

Ky Seksion poashtu është përgjegjës për përgatitjen dhe hartimin e praktikave dhe procedurave të licencimit si dhe udhëheqë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin e licencimit të kompanive që janë nën mandatin rregullator të ZRRUM-it.

Departamenti i Administratës dhe Financave të ZRRUM-it

Departamenti i Administratës dhe Financave është përgjegjës për funksionimin administrativ dhe financiar të ZRRUM-it. Ky Seksion i ofron

mbështetje administrative, gjuhësore, të menaxhimit të të dhënave, dhe të mbikqyrjes së financave të brendshme për Drejtorin dhe stafin e ZRRUM-it.

Poashtu ky Seksion menaxhon prokurimin, procesin e buxhetimit, resurset njerëzore, dhe aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me objektin administrativ dhe automjetet e ZRRUM-it.

2. Synimet Operative të ZRRUM-it

2.1. Synimet Operative

ZRRUM është i përkushtuar që në vitin 2010 të arrijë përmbushjen e synimeve operative si vijon:

Synimi 1: **Avansimi i procesit të përcaktimit të tarifave** për shërbimet e ujit dhe mbeturinave të ngurta që mundësojnë qëndrueshmëri afatgjatë financiare të ofruesve të shërbimeve

Për arritjen e këtij synimi janë planifikuar të ndërmerren aktivitetet vijuese:

- (i) Monitorimi i shpenzimeve operative dhe atyre kapitale të kompanive të licencuara të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe rishikimi vjetor i tarifave;
- (ii) Avansimi i procesit të përgatitjes së Planeve të Biznesit nga ana e kompanive të Licencuara. Në këtë kontekst ZRRUM do të bashkëpunojë me kompanitë e licencuara si dhe me palët tjera të interesit për ngritjen e cilësisë së Planeve të Biznesit të tyre si dokument qendror mbi të cilin mbështetet procesi tarifor dhe procesi rregullator në përgjithësi. Përmbushja e objektivave dhe caqeve të përcaktuara me Planet e Biznesit do të monitorohet rregullisht nga ZRRUM dhe vendimet rregullatore do të bazohen në efektivitetin dhe efikasitetin e kompanive në përmbushjen e këtyre objektivave;
- (iii) Përcaktimi kalendarit rregullator për përcaktimin e tarifave për kompanitë e mbeturinave dhe kompaninë Ibër-Lepenci (tarifat e të cilave përcaktohen për afat 1-vjeçar) me përkrahjen e detajuar të afateve për aktivitetet konkrete si: informacionet e kërkuara, afatet e dorëzimit, proceset e konsultimit dhe procesi i aprovimit;
- (iv) Shqyrtimi i detajuar i të dhënave të kompanive në aplikacionet e tyre tarifore dhe në planet e tyre të biznesit;

- (v) Zhvillimi i procesit të konsultimit me Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve për tarifave të propozuara;
- (vi) Aprovimi i tarifave të reja për kompanitë e mbeturinave dhe Ibër-Lepencin, si dhe rishikimi i tarifave për kompanitë e ujësjellësit dhe korrigjimi eventuale i tyre;
- (vii) Bashkëpunimi i ngushtë me kompaninë konsulente në avansimin e metodologjisë tarifore duke përfshirë edhe mbështetjen e kompanive të licencuara për të qenë në gjendje të përmbushë kërkesat e ZRRUM lidhur me procesin tarifor.

Synimi 2: Përmirësimi i performancës operative dhe financiare të kompanive të ujësjellësit dhe mbeturinave.

Për arritjen e këtij synimi janë planifikuar të ndërmerren aktivitetet vijuese:

- (i) Bashkëpunimi me Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPM të NP) të MEF-it si dhe me palët tjera të interesit për Marrëveshje të Performancës si një kornizë për vlerësimin e performancës së kompanive të licencuara të ujësjellësit dhe për ngritjen e efikasitetit operativ të tyre;
- (ii) Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së kompanive të ujësjellësit dhe atyre të mbeturinave, si dhe raportimi publik për nivelin e performancës së tyre;
- (iii) Nxitja e konkurrencës ndërmjet kompanive respektive të ujësjellësit dhe atyre të mbeturinave përmes performancës krahasuese dhe rangimit kompanive;
- (iv) Ngritja e saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara nga ofruesit e shërbimeve përmes procesit të auditimit të tyre.
- (v) Rishikimi i sistemit të vlerësimit dhe rangimit të kompanive dhe zhvillimi i i mëtutjeshëm i këtij sistemi.
- (vi) Përpilimi dhe publikimi i raportit vjetor të performancës së ofruesve të shërbimeve për vitin 2009.

Synimi 3: Ngritja e nivelit të zbatimit të standardeve të shërbimit nga ana e kompanive të ujësjellësit dhe mbeturinave.

Për arritjen e këtij synimi janë planifikuar të ndërmerren aktivitetet vijuese:

- (i) Monitorimi i rregulltë i nivelit të përmbushjes së standardeve të shërbimit nga ana e kompanive të licencuara përmes raporteve të dorëzuara nga to dhe përmes inspektimeve;
- (ii) Identifikimi i standardeve të cilat nuk përmbushen aktualisht nga kompanitë e licencuara dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për lirim të afatizuar nga përmbushja e standardeve resepektive;
- (iii) Mbajtja e takimeve dhe workshopeve me kompanitë e licencuara me qëllim të diskutimit të problemeve që kanë ato në përmbushjen e standardeve të shërbimit dhe dakordimit të veprimeve korrektuese;
- (iv) Bashkëpunimi me Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve për adresimin e ankesave dhe shqetësimeve të konsumatorëve lidhur me nivelin e shërbimeve që ofrohen nga kompanitë e licencuara;
- (v) Rishikimi i standardeve të shërbimit në konsultim me kompanitë e licencuara dhe KKK-të.

Synimi 4: **Përforcimi i pavarësisë rregullatore dhe pavarësisë financiare** të ZRRUM-it si rregullator ekonomik i sektorit të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave me legjitimitet dhe pavarësi të plotë dhe të qartë, që iu përgjigjet institucioneve të Kosovës.

Për arritjen e këtij synimi janë planifikuar të ndërmerren aktivitetet vijuese:

- (i) Angazhimi, në bashkëpunim me institucionet relevante, për amendamentimin e Ligjit Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujës, Kanalizimit dhe Mbeturinave ose nxjerrjen e Ligjit të ri që do të zëvendësonte këtë ligj;
- (ii) Rishikimi dhe modifikimi eventual i planit strategjik 3-vjeçar;
- (iii) Faturimi dhe inkasimi i rregulltë i taksave të licencimit si burim për financimin e aktiviteteve të ZRRUM-it;
- (iv) Zhvillimi i mëtutjeshëm i politikave dhe procedurave të brendshme administrative;
- (v) Ngritja e kapaciteteve profesionale të ZRRUM-it përmes trajnimeve dhe vizitave studimore

Synimi 5: **Ngritja e transparencës dhe besimit në procesin rregullator** të palët e interesit

- (i) Publikimi dhe shpërndarja e të gjitha çështjeve dhe vendimeve rregullatore në gjuhët zyrtare në disa pika të

- qasjes së informatave (web-faqe, media elektronike dhe të shkruara, konferenca për shtyp etj.).
- (ii) Zhvillimi i dhe avansimi i sistemit të relacioneve me publikun dhe planeve të komunikimit me publikun.
 - (iii) Krijimi i procedurave të procesit të konsultimit.
 - (iv) Avansimi i rolit dhe ngritja e profilit të Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve.
 - (v) Inicimi i idesë për krijimin e Komitetit Këshillues që do të përbëhej nga palët kyçe të interesit (institucionet akademike, institucionet qeveritare, shoqëria civile, konsumatorët etj.) me qëllim të përfshirjes sa më të gjërë në procesin rregullator.
 - (vi) Zhvillimi i relacioneve të mira dhe bashkëpunimit me rregulatorët tjerë dhe institucionet tjera relevante të sektorit të ujit dhe mbeturinave në Kosovë.

Arritjen e synimeve operationale ZRRUM e bën përmes departamenteve përkatëse të ZRRUM-it në formën e aktiviteteve përkatëse siq janë paraqitur në Planin e Veprimit për vitin 2010.

3. Të Hyrat e ZRRUM-it në 2010

3.1. Të Hyrat nga Taksat e Licencimit

Në pajtim me Ligjin Nr.03/L-086, ZRRUM do ti financojë aktivitetet e veta të planifikuara për vitin 2010 nga të hyrat e realizuara përmes taksave të licencimit që paguajnë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave.

Në vitin 2010 ZRRUM planifikon të mbledhë taksat e licencimit prej 16 ofruesve të licencuar që ofrojnë shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza, grumbullimit të mbeturinave dhe të deponimit të mbeturinave, si vijon:

- 7 ofrues regional të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza;
- 1 ofrues i shërbimeve të ujit me shumicë;
- 7 ofrues regional të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave; dhe
- 1 ofrues i shërbimeve që menaxhon deponitë.

Vlera totale e faturimit për taksat e licencimit duhet të korrespondojë me shpenzimet e buxhetuara të ZRRUM-it për vitin 2010, të përlllogaritura në vlerë **344,520.00 EUR**. Kjo vlerë do të faturohet te 16 kompanitë e licencuara si përqindje në qarkullimin vjetor bruto të këtyre kompanive.

Lartësia e taksës vjetore të licencimit për ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave është përlllogaritur në bazë të qarkullimit vjetor në vitin 2008.

Bazuar në këto përlllogaritje lartësia e taksës vjetore të licencimit për vitin 2010 që ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave duhet ti paguajnë ZRRUM-it **është 1.07%** të qarkullimit të tyre vjetor bruto, që është në suazat e kufirit të përcaktuar me Ligjin nr. 03/L-086 (max. 1.5 % e qarkullimit bruto vjetor). Tabela 3.2 jep pasqyrën e lartësisë së taksës së licencimit që duhet të paguajë secila prej kompanive të licencuar tek ZRRUM.

Tabela 3.1 jep pasqyrën e qarkullimit vjetor të ofruesve të shërbimeve që paraqet bazën për llogaritjen e vlerës së taksës vjetore të licencimit që do tu faturohet atyre nga ZRRUM-i.

3.2. Donacionet

Në kontekst të përfitimeve nga mbështetja e donatorëve, duhet të përmendet fakti se ZRRUM ka arritur marrëveshje me Zyrën Zvicëranë për Zhvillim (SCO)

për vazhdimin e projektit OFMP të financuar nga SCO edhe për gjashtë muaj të vitit 2010. Ky projekt ka filluar të implementohet në fillim të vitit 2008 dhe ka qenë parapa të përfundojë në fund të vitit 2009, dhe konsiston në financimin e një eksperti lokal që do të mbështesë ZRRUM-in lidhur me monitorimin e performansës së ofruesve të shërbimeve.

Poashtu, në pjesën e parë të vitit 2010 pritet të fillojë implementimi i projektit mbështetës financiar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit European (ZNKE) si mbështetje institucionale për ZRRUM. Ky është projekt 2-vjeçar që ka për qëllim ti ofrojë ZRRUM mbështetje në formën e ekspertizës profesionale në zhvillimin dhe implementimin e metodologjisë për përcaktimin e tarifave. Me projekt parashihet ngritja e kapaciteteve të ZRRUM dhe kompanive të ujësjellësit për implementimin e metodologjisë tarifore të bazuar në parimin e mbulimit të kostove, me fokus të veçantë në hartimin e rregullave dhe udhëzuesve lidhur me kontabilitetin rregullator si dhe lidhur me planifikimin e menaxhimit të aseteve. Vlera parallogaritë e projektit është 1.8 milion EUR.

ZRRUM do të bashkëpunojë ngushtë me konsulentët e këtyre projekteve në mënyrë që ti maksimalizojë benfitet nga këto projekte.

Tabela 3.1: Qarkullimi bruto vjetor i ofruesve të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave në vitin 2008

SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA DHE UJIT ME SHUMICË			SHËRBIMETE E MBETURINAVE		
Emri i Ofruesit të Shërbimeve	Regjioni	Qarkullimi bruto vjetor (EUR)	Emri i Ofruesit të Shërbimeve	Regjioni	Qarkullimi bruto vjetor (EUR)
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "PRISHTINA"	Prishtina	9,402.000	Kompania Regjionale e Grumbullimit të Mbeturinave "AMBIENTI"	Pejë	987,944
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "BIFURKACIONI"	Ferizaj	971,000	Kompania Regjionale e Grumbullimit të Mbeturinave "EKO-REGJIONI"	Prizren	1,770,146
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "RADONIQI"	Gjakovë	2,545,000	Kompania Regjionale e Grumbullimit të Mbeturinave "PASTERTIA"	Ferizaj	985,742
Ofruesi i Ujit me Shumicë "IBER-LEPENCI"	Prishtinë	274,410	Kompania Regjionale e Grumbullimit të Mbeturinave "UNITETI"	Mitrovicë	1,141,111
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "UJESJELLSI REGJIONAL"	Mitrovicë	2,650,000	Kompania Regjionale e Grumbullimit të Mbeturinave "CABRATI"	Gjakovë	468,454
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDRODRINI"	Pejë	2,152.000	Kompania Regjionale e Grumbullimit të Mbeturinave "HIGJIENA"	Gjilan	1,011,652
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROREGJIONI"	Prizren	2,476.000	Kompania Regjionale e Grumbullimit të Mbeturinave "PASTRIMI"	Prishtinë	3,614,468
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROMORAVA"	Gjilan	1,247.000	Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë (KLMC/KMDK)	Prishtina	923,674
Totali – Ofruesit e Ujit dhe Ujërave të Zeza		21,443,000	Totali – Ofruesit e Shërbimeve të Mbeturinave:		10,903,191
TOTALI:					32,346,191

Tabela 3.2: Lartësia e Taksës së Licencimit të ofruesve të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave për vitin 2010

SHËRBIMET E UJIT, UJËRAVE TË ZEZA DHE UJIT ME SHUMICË			SHËRBIMET E GRUMBULLIMIT DHE DEPONIMIT TË MBETURINAVE		
Ofruesi i Shërbimeve	Qarkullimi Vjetor Bruto (EUR)	Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)	Ofruesi i Shërbimeve	Qarkullimi Vjetor Bruto (EUR)	Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)
KUR "PRISHTINA" SH.A. Prishtinë	9,402,000.00	100,601.40	KRM "PASTRIMI" SH.A. Prishtinë	3,614,468.00	38,674.81
KRU "HIDROREGJIONI" SH.A. Prizren	2,476,000.00	26,493.20	KRM "EKOREGJIONI" SH.A. Prizren	1,770,146.00	18,940.57
KRU "HIDRODRINI" SH.A. Pejë	2,152,000.00	23,026.40	KRM "AMBIENTI" SH.A. Peja	987,944.00	10,571.00
KRU "HIDROMORAVA" SH.A. Gjilan	1,247,000.00	13,342.90	KRM "HIGJIENA" SH.A. Gjilan	1,011,652.00	10,824.68
KRUK "BIFURKACIONI" SH.A. Ferizaj	971,000.00	10,389.70	KRM "PASTERTIA" SH.A. Ferizaj	985,742.00	10,547.44
KRU "MITROVICA" SH.A., Mitrovicë	2,650,000.00	28,355.00	KRM "UNITETI" SH.A. Mitrovica	1,141,111.00	12,209.89
KRU RADONIQI" SH.A. Gjakovë	2,545,000.00	27,231.50	KRM "CABRATI" SH.A. Gjakova	468,454.00	5,012.46
Hidrosistemi " IBËR-LEPENCI" SH.A. Prishtinë	274,410.00	2,936.19	SH.A. KLMC/KMDK SH.A. Prishtinë	923,674.00	9,883.32
Totali – Ofruesit e Shërbimeve të Ujit		232,376.29	Totali – Ofruesit e Shërbimeve të Mbeturinave:		116,664.17
Totali – Taksa Vjetore e Licencimit:					349,040.46

4. Shpenzimet e ZRRUM në 2010

4.1. Shpenzimet e Personelit

Personeli i ZRRUM-it në vitin 2010 do të konsistojë në 19 të punësuar, që të gjithë staf vendor.

Lartësia e pagave për stafin është dhënë në tabelën 4.1, dhe këto paga janë përcaktuar ashtu që të njëjtat të jenë në nivel që është i krahasueshëm me nivelin e pagave që marrin të punësuarit në sektorin e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave në Kosovë si dhe në nivel të krahasueshëm me nivelin e rregullatorëve tjerë ekonomik në Kosovë. Kjo është sipas ZRRUM-it e domosdoshme për të qenë në gjendje për të motivuar stafin me paga konkurruese me sektorin e shërbimeve që është objekt i rregullativës së ZRRUM-it dhe për tu mbrojtur nga dukuria e largimit të ekspertëve nga ZRRUM-i, pra për ta ruajtur ekspertizën e krijuar gjatë viteve të kaluara. Kjo për faktin se si pasojë e pagave të ulëta (në nivel të shërbuesve civil) ZRRUM prej themelimit të vet në nëntor 2004 ka humbur 12 të punësuar të cilët pasi janë aftësuar në kuadër të aktiviteteve trajnuese janë larguar me arësytim të pagave më të mira se ato që ka qenë në gjendje të ofrojë ZRRUM.

Pagat e Personelit të ZRRUM janë përcaktuar në bazë të politikave të pagave të ZRRUM që parasheh pagën bazë dhe shtesën deri në 10% që iu jipet stafit në varësi prej performancës së tyre. Kjo politikë është nxjerrë me qëllim të ngritjes së cilësisë së punës dhe motivimit të stafit për performancë cilësore.

Shpenzimet për Paga dhe Mëditje janë **155,570.00 EUR**.

Tabela 4.1: Skema e Pagave të Personelit të ZRRUM-it

SKEMA E PAGAVE TË ZRRUM-it 2010

No.	Titulli - Pozita	Përgatitja Profesionale			Gjuhët			Kat. e Pagës
		Post-Diplomik	Diploma e Universitetit	Shkolla e mesme	Shqip	Serb.	Ang.	
1	Drejtori i ZRRUM-it		x		x	x	x	VII
2	Zv.Drejtori		x		x	x	x	VI
3	Asistenti Personal dhe Zyrtar i RP			x	x	x	x	II
4	Udhëheqës i Administratës dhe Financave		x		x	x	x	V
5	Zyrtar i Administratës dhe Burimeve Njerëzore		x		x	x		III
6	Zyrtar i Buxhetit dhe Financave		x		x	x		III
7	Zyrtar i Prokurimit		x		x	x		IV
8	Zyrtar i Shërbimeve IT		x		x	x	x	IV
9	Përkthyes profesional (shqip/serbisht/anglisht)		x		x	x	x	IV
10	Pastrues dhe Mirëmbajtës			x	x			I
11	Udhëheqës i Tarifave dhe Financave Rregullatore		x		x	x	x	V
12	Analist i Aseteve dhe Investimeve Kapitale		x		x	x	x	IVa
13	Analist i Tarifave dhe Financave - Ujë & Ujëra të Zeza		x		x	x	x	IVa
14	Udhëheqës i Departamentit të Performansës		x		x	x		IVa
15	Analist i Shërbimeve të Konsumatorëve		x		x	x	x	V
16	Analist i Monitorimit të Performansës		x		x	x		IVa
17	Analist i Performancës dhe Inspektimit financiar		x		x	x		IVa
18	Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe të Licencave		x		x	x		IVa
19	Zyrtar i Licencimit			x	x	x		III

4.2. Mallëra dhe Shërbime

Shpenzimet e parapara të ZRRUM për kategorinë Mallëra dhe Shërbime si dhe Shpenzimet për Shërbimet Publike janë dhënë në tabelat vijuese (Tabela 4.3 dhe Tabela 4.4), në vijim:

Shuma totale e shpenzimeve për Mallëra dhe Shërbime është: 182,300 EUR.

Tabela 4.3: Shpenzimet për Mallëra dhe Shërbime

SHPENZIMET PËR MALLËRA DHE SHËRBIME		
Lloji i Shpenzimit	Vlera (EUR)	Vërejtje:
Shpenzimet e Udhëtimit	17,500	Pjesëmarrje ne seminare nderkombtare
Karburante për vetura	7,500	5 vetura
Karburante për gjenerator	2,500	1 gjenerator
Karburante për nxemje	5,500	
Mirëmbajtja dhe riparimi i objektit	3,000	
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve(rexhistrimi	2,500	5 vetura
Telekomunikacionet	5,700	Kartelat për tel. (25x19x12)
IT shërbimet (internet)	3,000	
Shpenzimet e reprezentacionit	2,500	
Prezentimet dhe workshopet	5,000	
Shërbimet kontraktuale	12,000	Shërbimet e sigurimit
Shërbimet edukative dhe të trajnimit profesional	12,000	
Shërbimet tjera të kontraktuara	5,000	Shpalljet, RP, Publikimet, konkurset
Sondazhet e Komisioneve Konsultative të Konsumatorëve	8,000	
Inventar i Zyrës	1,500	
Teknologjia Informative	2,500	Blerja e 5 kompjuterave
Pajisje tjera	8,500	Blerja e një serveri
Qiraja për Zyrë	42,000	
Furnizimet për Zyrë	8,500	
Furnizimet tjera	1,000	
Shpenzimet tjera për Mallëra dhe Shërbime	2,000	
Shpenzimet për Komisione Konsultative të Konsumatorëve*(KKK)	24,600	Shpenzimet e rrugës dhe të tjera të anëtarëve të KKK (82x25x12)
Total – Mallëra dhe Shërbime:	182,300	

Tabela 4.4: Shpenzimet për Shërbime Publike (Komunale)

SHPENZIMET PËR SHËRBIMET KOMUNALE		
Shpenzimet e ujit	800	
Shpenzimet e energjisë elektrike	3,550	
Shpenzimet mbeturinave	500	
Shpenzimet e telefonisë fikse	1,800	
Total – Shpenzimet Komunale:	6,650	

4.3. Shpenzimet Totale të ZRRUM për vitin 2010

Në tabelën vijuese (Tabela 4.5) është dhënë përmbledhja e shpenzimeve totale të ZRRUM-it të parashikuara për vitin 2010 të ndara sipas kategorive: (i) Paga dhe Mëditje, (ii) Mallëra dhe Shërbime, dhe (iii) Shërbime Publike.

Tabela 4.5: Shpenzimet totale të ZRRUM-it në vitin 2010

SHPENZIMET TOTALE TË ZRRUM NË 2008	
1. Paga dhe Mëditjehpenzimet e Personelit	155,570.00
2. Shpenzimet e Mallërave dhe Shërbimeve	182,308.00
3. Shpenzimet e Shërbimeve Publike	6,650.00
Total - Shpenzimet e ZRRUM:	344,520.00

5. Konkluzion

Të hyrat e ZRRUM-it nga taksat e licencimit për mbulimin e shpenzimeve rrjedhëse pritet të ndodhin në baza mujore për të korresponduar me shpenzimet e ZRRUM-it të cilat janë të njëtrajtshme përgjatë tërë vitit.

Në rast të problemeve në arkëtimin të taksës së licencimit nga kompanitë e licencuara, ZRRUM do të duhet të kërkojë alokime nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për të qenë në gjendje me i përmbushë përgjegjësitë e veta ligjore dhe për të ushtruar veprimtarinë e vet rregullatore.

Tetor 2009

Drejtori i ZRRUM

Afrim Lajçi